

VENDIM
Nr. 241, datë 21.12.2020

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC ZALL XHUXHË” SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“XHUXHË 1”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 3487 kw, DHE HEC “XHUXHË 2”,
ME KAPACITET TË INSTALUAR 1254 kw, DHE ME KAPACITET TOTAL TË
INSTALUAR 4741 kw**

(Ndryshuar me vendimin nr. 106, datë 22.4.2021)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “a”, dhe nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, të nenit 5, pika 1, germa “a” dhe të nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 135/12 prot., datë 17.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi aplikimin e shoqërisë “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 187, datë 16.11.2020, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Zall Xhuxhë 1”, me kapacitet të instaluar 3487 kw, dhe HEC “Zall Xhuxhë 2”, me kapacitet të instaluar 1254 kw, dhe kapacitet total të instaluar 4741 kw, me vendndodhje në kaskadën e përroit të Zall Xhuxhë, degë e Lumit Fan i Vogël, Bashkia Mirditë.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, me “Njoftimin për licencim” nr. 62/58 prot., datë 17.11.2020, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 1165/1 prot., datë 26.11.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “HEC ZALL Xhuxhë” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1165/2, datë 3.12.2020, ka përcjellë dokumentacionin e munguar.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi është i plotësuar kryesisht, dhe më poshtë veçojmë dokumentacionin i cili mbetet i pa plotësuar:

- neni 9, pika 2, germa “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse. Në rastin e aplikimeve për licencë prodhimi të energjisë elektrike kërkohet paraqitja e licencës për drejtues teknik elektrik). Pavarësisht shpjegimit që ka dhënë shoqëria “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k., ajo duhet të përcjellë licencën e drejtuesit të saj teknik elektrik, dhe si e tillë vlerësohet që kjo kërkesë të vendoset si kusht në këtë vendim, për depozitimin e saj në ERE, brenda 3 muajve nga marrja e vendimit të licencimit;

- neni 9, pika 3, germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore). Shoqëria nuk ka depozituar vërtetimet përkatëse, për

rrjedhje vlerësohet që kjo kërkesë të vendoset si kusht në këtë vendim, për depozitimin e tij në ERE, brenda 3 muajve nga marrja e vendimit të licencimit;

- neni 9, pika 4.1.4, germa “a”. Studimi i fizibilitetit. Shoqëria nuk ka përcjellë në ERE studim fizibiliteti dhe në vijim vlerësohet që kjo kërkesë e rregullores të vendoset si kusht në këtë vendim, për depozitimin e tij në ERE, brenda 3 muajve, të vendimit të licencimit.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, sipas “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Në përfundim të afatit të lejes për përdorim të burimit ujor (datë 25.7.2023), do t’i kërkohet shoqërisë të depozitojë në ERE, lejen e rinovuar në afate, jo më vonë se 30 ditë pas nënshkrimit të rinovimit të saj.

- Në përfundim të afatit të kontratës për dhënien në përdorim të sipërfaqeve fond pyjor dhe kullosor në administrim të Bashkisë Mirditë, në funksion të ndërtimit të HEC “Zall Xhuxhë” (datë 19.6.2028), i kërkohet shoqërisë të depozitojë në ERE lejen e rinovuar në afate, jo më vonë se 30 ditë pas nënshkrimit të rinovimit të saj.

- Shoqëria ka përcjellë në ERE “Deklaratën mjedisore”, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit me nr. 2945/1 prot., datë 26.3.2019, me nr. 266 identifikimi dhe nr. 15 vendimi, për personin juridik “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k., “Për të zhvilluar projektin: Ndërtim i HEC Zall Xhuxhë 1 dhe Zall Xhuxhë 2”.

- Kontrata nr. 10329 rep., nr. 3323 kol., datë 9.9.2013, “Kontratë koncesioni për ndërtimin e hidrocentraleve Zall Xhuxhë nr. 1 dhe Zall Xhuxhë nr. 2” e lidhur midis METE-s (sot MIE) dhe Bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Gloris Construction” sh.p.k. dhe “Gjoka Construction” sh.p.k., ka një afat 35-vjeçar, por nga ana tjetër shpjegojmë se ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ERE nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet. Nga sa konstatuar, kjo shoqëri ka humbur 7 vite e tre muaj nga koncesioni i saj.

- Në këto kushte, në zbatim të nenit 5, pika 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, vlerësohet se shoqëria nuk mund të licencohet me një afat përtej atij koncesionar. Periudha e mbetur e koncesionit është 27 vite e 9 muaj dhe si e tillë edhe licenca e lëshuar nga ERE do të mbaje të njëjtin afat.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “HEC Zall Xhuxhë” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Zall Xhuxhë 1”, me kapacitet të instaluar 3487 kW, dhe HEC “Zall Xhuxhë 2”, me kapacitet të instaluar 1254 kW, dhe kapacitet total të instaluar 4741 kW, për një afat 27 vjet e 9 muaj.

2. Në përfundim të afatit të lejes për përdorim të burimit ujor (25.7.2023), shoqëria të depozitojë në ERE lejen e rinovuar në afate, jo më vonë se 30 ditë pas nënshkrimit të rinovimit të saj.

3. Në përfundim të afatit të kontratës për dhënien në përdorim të sipërfaqeve fond pyjor dhe kullosor në administrim të Bashkisë Mirditë, në funksion të ndërtimit të HEC “Zall Xhuxhë 1” dhe HEC “Zall Xhuxhë 2” (19.6.2028), shoqëria të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar në afate, jo më vonë se 30 ditë pas nënshkrimit të saj.

4. Mos plotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti